imati (neko) laku ruku	e ka dorën e lehtë (dikush)	SRB: biti majstor u davanju injekcija: Sestra ima laku ruku, ne osetiš kad te ubode. ALB: nuk e ndien shumë kur të bën gjilpërën: Infermierja e ka dorën e lehtë, nuk ndien kur të shpon.
ne vredi ni prebijene pare ne vredi ni filera (filira) ne vredi (ni) pola groša	s'bën një lek s'bën (s'vlen) asnjë dysh	SRB: biti bez ikakve vrednosti; potpuno bezvredno, ne vredi ništa: Em hoćeš da kupiš sliku, em kažeš da ne vredi ni prebijene pare. ALB: nuk vlen fare; s'ka asnjë vlerë, nuk ke ç'e do, nuk të hyn në punë fare: Edhe do ta blesh pikturën, edhe thua se s'bën një lek.
pasti (tresnuti, ljosnuti, pružiti se) koliko je duga	zuri lepurin u shtri sa gjatë e gjerë	SRB: pasti na zemlju celom dužinom tela: Trčeći za busom pade koliko je duga. ALB: bie për toke, u shtri sa gjatë e gjerë: Duke vrapuar pas autobusit e zuri lepurin.
psovati kao kočijaš (amalin, hamalin)	nxjerr lerë (nga goja) vjell vrer shan rëndë	SRB: psovati mnogo, često i pogrdno: Mene je sramota od njega, psuje kao kočijaš. ALB: thotë fjalë të ndyra e të turpshme; shan rëndë: Mua më vjen turp nga ai, nxjerrë lerë.
Gordijev čvor zamršeno (zapleteno) kao creva	është bërë lëmsh (përshesh; lesh e li; lesh arapi; këmbë e krye) nuk i gjendet filli	SRB: veoma komplikovano, zapetljano, zamršeno: Uzmi makaze i seci, ovo je Gordrijev čvor. ALB: është bërë rrëmujë; është ngatërruar diçka; është përzier diçka: Merri gërshërët e preje se është bërë lesh e li.
Gordijev čvor zamršeno (zapleteno) kao creva	i shtiu veshët në lesh (në tul) (dikush) bën veshin të shurdhër shtiu shurdhat nuk i vuri veshin (dikujt a diçkaje)	SRB: praviti se nevešt, neobavešten o nečemu, neupućen u nešto: Vest o skandalu se brzo proširila, ali on se pravio lud. ALB: nuk i kushtoi vëmendje diçkaje; bëri sikur e dëgjoj a nuk e kuptoi diçka; hiqet sikur nuk di gjë për diçka: Lajmi për skandalin u përhap shpejtë, por ai i shtiu veshët në lesh.
pasti mrak na oči imati mreću na očima	i kanë zënë sytë lesh	SRB: biti zaslepljen, nesposoban za normalno gledanje i zaslepljen: Obrazovan si, čitaš puno, ali pao ti je mrak na oči što se tiče politike. ALB: nuk është në gjendje t'i shohë gjërat ashtu siç janë, nuk i sheh më të metat ose gjërat e këqija, është i verbëruar, sylesh: Ti je i arsimuar, lexon shumë, por sytë të paskan zënë lesh sa i përket politikës.
igrati se žmurke (s nekim)	i fshehu (i mbuloj) letrat (kartat)	SRB: prikrivati svoje namere; ne otkrivati svoje planove; skrivati nešto: Opet se igrao žmurke sa njima i nisu uspeli da shvate njegove namere. ALB: nuk foli hapur; i mbuloi qëllimet e planet që ka bërë, i fshehu synimet: Prapë i fshehu letrat dhe nuk arritën të kuptojnë qëllimet e tij.
otvorenih karata (s otvorenim kartama)	me letra të hapura	SRB: jasno iznositi svoje namere; ne kriti ništa: Od sada ćemo razgovarati otvorenih karata i značeš moje mišljenje. ALB: foli hapur me dikë, i tha qartë ç'kishte ndërmend: Tash e tutje do të flasim me letra të hapura e do ta dish mendimin tim.
pročitati nekoga	t'i lexon letrat në xhep	SRB: shvatiti kakav je neko ili kakve su njegove namere; kakvo je nečije mišljenje: Pročitao sam je čim sam je video, nemoj da se družiš sa njom. ALB: të kupton menjëherë, ta zbulon mendimin vetë, të zbulon çdo të fshehtë: Ia lexova letrat në xhep si e pashë, mos u shoqëro me të.

ostati (mrtvo slovo) na papiru	mbeti në letër	SRB: biti zapisano, planirano ali neostvareno, nepretvoreno u delo: Njihovo dogovor je ostao samo mrtvo slovo na papiru. ALB: i tha me fjalë a u shkrua në një vendim, por nuk u realizua kurrë, nuk u bë e nuk u zgjidh: Marrëveshja e tyre mbeti vetëm në letër.
zlo i naopako ubij Bože ne pitaj	mos pyet lumë e det keq e më keq	SRB: ne može biti gore; najgore moguće: Ubij Bože kako živimo, dolaze sve gora vremena. ALB: shumë keq, nuk mund të jetë më keq: Mos pyet si jetojmë, po vijnë kohërat gjithnjë më të vështira.
čuvati svoja leđa (zadnjicu, guzicu)	ruan (lëkurën) e vet	SRB: brinuti o svojoj bezbednosti; ne želeti izlagati se opasnostima ili neprilikama: Sve bi uradio, i lagao bi, samo da sačuva svoja leđa. ALB: mbron vetëm veten, rihet të mos pësojë gjë vetë, edhe pse të tjerët mund të dëmtohen: Do të bënte çdo gjë, edhe kishte gënjyer, vetëm për ta ruajtur lëkurën e vet.
izvući mačku rep	i ka parë (shumë) lëkura	SRB: namučiti se oko nečega; uložiti veliki napor; propatiti: Još je dete bio kada mu je cela kuća bila na ramenima, izvukao je mačku rep. ALB: ka vuajtur shumë, ka hequr në jetë lloj-lloj mundimesh, është regjur në vuajtje e në mendime: Ende ishte fëmije kur tërë shtëpia ishte mbi supet e tij, i ka parë shumë lëkura.
biti u nečijoj koži staviti se na nečije mesto	e vë (fut) vetën në lëkurën time	SRB: naći se u nečijem položaju (obično nepovoljnou): Ne možeš da me razumeš dok ne budeš bio u mojoj koži. ALB: mendoj a zë sikur të isha në vend të dikujt, e vë vetën në pozitën e tij: Nuk mund të më kuptosh deri sa s'e vë veten në lëkurën time.
pljunuti pa lizati polizati pljunuto	lëpin atë që e pështyn	SRB: negirati sebe: Kada su mu radnici pripretili otkazima, direktor je polizao pljunuto i povećao im plate. ALB: i merr prapa me turp ato që i ka thënë njëherë, pranon se ka bërë shpifje ose që ka folur gjëra të paqena; e mohon vetveten: Kur e kërcënuan punëtorët me dorëheqje, drejtori lëpiu atë që ka pështyrë, dhe ua rriti rrogat.
biti kao otvorena knjiga	libër i hapur	SRB: biti lako proziv, razumljiv; iskren: Ne moraš ga dva puta pitati, on je kao otvorena knjiga. ALB: njeri i çiltër, pa të fshehta, që gjithkush e njeh shpejt e e kupton lehtë: Nuk ke nevojë ta pyesësh dy herë, ai është libër i hapur.
vedriti i oblačiti	lidh e zgjidh	SRB: činiti kako ti je volja, biti svemoćan i imati glavnu reč: A ona je vedrila i oblačila, nije marila ni za koga i radila je sve kako je htela. ALB: bën e vendos si të do vetë, nuk e pyet askënd për asgjë: Ajo lidhte e zgjidhte, nuk i bëhej vonë për askënd, çdo gjë bënte siç donte vet.
roditi se ponovo	linda për së dyti	SRB: biti u boljem stanju i mnogo srećniji: Od kako sam njega upoznala, ponovo sam se rodila. ALB: dola në një jetë më të mirë a në një gjendje të sigurt; jam shumë i lumtur: Që kur e takova linda për së dyti.
može volu rep da iščupa	e pret lisin me një të rënë (me një sëpatë)	SRB: veoma jak čovek: Nije to za njega ništa, on može volu rep da iščupa. ALB: njeri i fuqishëm e i zoti që kryen punë menjëherë: Nuk është asgjë ajo punë për të, ai e pret lisin me në të rënë.

omrsiti uže (konopac)	shkoi në litar	SRB: biti obešen; završiti na vešalima: U srednjem veku, lako si mogao omrsiti uže. ALB: e varën: Në mesjetë shumë lehtë mund të shkojë në litar.
igra (dvostruku) igru	bën lojë të dyfishtë	SRB: radi tajno i obmanjuje sarađujući istovremeno sa dva protivnika: Igrala je dvostruku igru, ali smo se mi pravili kao da se ništa ne događa. ALB: punon me hile e mashtron, duke bashkëpunuar njëherazi me të dy kundërshtarët: Ajo po bënte lojë të dyfishtë por ne u shtrimë sikur të mos ndodhte asgjë.
deçja igra	lojë fëmijësh (kalamajsh)	SRB: nešto vrlo jednostavno; laka stvar; sitnica: Uozbiljite se, nije ovo dečja igra! ALB: diçka që mund të bëhet fare lehtë, pa ndonjë mundim; punë shumë e thjeshtë: Bëhuni serioz, nuk është kjo lojë fëmijësh!
igra reči	lojë fjalësh	SRB: nešto što se u šali kaže ili zbog drugih namera, koristeći reči koje zvuče slično, ali imaju drugačije značenje: Tim rečima, pisac je napravio igru reči. ALB: diçka që thuhet për shaka a për qëllime të tjera, duke përdorur fjalë që tingëllojnë njësoj ose në mënyrë të ngjashme, por që kanë kuptime të ndryshme: Me këto fjalë, shkrimtari bëri lojë fjalësh.
pustiti suzu	derdh lot	SRB: zaplakati: Uvek kada se setim pokojnog deke, pustim suzu. ALB: qaj: Gjithmonë, kur më kujtohet gjyshi, derdh lot.
pustiti suzu	lot krokodili	SRB: pretvarati se, lažno izražavati žaljenje, žalost: Iza krokodilskih suza krila su se njihova prava lica, zapravo nikome nije bilo žao. ALB: pikëllim i pasinqertë, qarje e shtirur: Pas lotësh krokodili fshiheshin fytyrat e tyre të vërteta, në të vërtetë askujt nuk i vinte keq.
nisu (tu) čista posla (stvari)	diçka luan (këtu, në këtë mes)	SRB: nije nešto u redu, nije jasno; nešto nije legalno, pošteno, u skladu sa zakonom: Brzo se obogatio, nisu tu čista posla! ALB: ka diçka t[ë] fshehtë, jo të çiltër e të qartë; nuk është siç duket kjo punë: U pasurua shpejtë, diçka luan këtu!
ići svojim putem čistiti pred svojim pragom	fshin oborrin e vet i fryn lugës së vet	SRB: ne mešati se u tuđe poslove, gledati svoja posla: Nikada nije voleo tračeve, uvek je išao svojim putem. ALB: shikon punët e veta e nuk përzihet në çështjet e tjerëve: Kurrë nuk i pëlqenin thashethemet, gjithmonë e fshinte oborrin e vet.
jesti kao mečava jesti kao gladna godina jesti kao gladna ala jede kao da je od gladi utekao	s'ia pret luga lugën	SRB: halapljivo i brzo jesti: Ceo dan je radio, pa kad je došao kući gladan, jeo je kao mečava. ALB: ha ne nxitim të madh ngaqë është e uritur: Tërë ditën ka punuar, e kur erdhi në shtëpi i uritur, s'ia priste luga ligën.
ne može ga (je) ni Dunav oprati	s'i lan (dot) as lumi	SRB: mnogo je grešan; načinio je mnoga zla, nepravde: Pokajali su se zbog prošlosti, ali njih ni Dunav ne može da opere. ALB: ka bërë shumë faje e të këqijat që i ka bërë nuk mund t'i shlyejë kurrë: U penduan për të kaluarën, por s'i lan dot as lumi.

stati nekome na žalj	i shkeli lythin	SRB: povrediti, ozlojediti nekoga; dirnuti nekoga u osetljivo i bolno mesto: Trpeo ih je dosta dok mu nisu stali na žalj. ALB: e preku atje ku i dhëmb më shumë, në pikën më të dobët: Mjaft i duroi, deri sa nuk i shkelën në lyth duke ia përmendur djalin e vdekur.
izvući (nekoga) iz blata	nxjerr nga balta (lluca, bataku)	SRB: pomagati nekome u nevolji: Kada mi je bilo najteže, on me je izvukao iz blata. ALB: e ndihmoi që të dilte nga gjendja e vështirë; e shpëtoi nga vështirësia: Kur ishte periudha më e vështirë për mua, ai më nxori nga balta.
biti težak na novcu Kir Janja ne dati Bogu ni tamjana	lidh macen	SRB: biti izuzetno škrt; ne davati nikome ništa: Kažu da su Piročanci teški na novcu. ALB: është koprrac i madh, është cingun: Thonë se gjakovarët e lidhin macen.
slagati se kao pas i mačka (kao ovca i vuk)	shkojnë si macja me miun (qeni me macen) shkojnë gjak e lak i kanë gjilpërat majë më majë shkojnë thikë e brisk e ka spec e uthull	SRB: ne slagati se; biti u lošim odnosima; živeti s nekim u stalnom neprijateljstvu: Brat i sestra, a slažu se kao pas i mačka. ALB: shkojnë shumë keq njëri me tjetrin, grinden e hahen vazhdimisht, nuk pajtohen kurrë: Vëlla e motër e shkojnë si macja me miun.
imati gladne oči uzeti zlo na oko pući od jeda (od zavisti)	e ka syrin e madh	SRB: postati zavidan; zavideti nekome: Nikad mu nije dosta, ima gladne oči. ALB: lakmon shumë, kërkon gjëra që nuk i përkasin ose që janë jashtë mundësive të tij, është lakmitar: Kurrë s'i mjafton asgjë, e ka syrin e madh.
popeti se na glavu doći (nekome) na vrh nosa doći do guše	ma pruri (solli) shpirtin në majë të hundës ma plasi shpirtin (buzën) më ka hipur në majë të kokës	SRB: doći do stanja koje se ne može više izdržati: Na glavu si mi se popela sa tvojim problemima. ALB: nuk e duroj dot më sa shumë më inatosi e më mërziti: Ma prure shpirtin në majë të hundës me problemet e tua.
nema gde igla da padne	s'ke ku ta hedhësh majën e gjilpërës	SRB: mesto u kojem nema više prostora ni za šta: Garaža je puna starih stvari, nema više gde igla da padne. ALB: vend ku s'ka më hapësirë për të vendosur gjëra: Garazha është plot me gjësende të vjetra, s'ke ku ta hedhësh majën e gjilpërës.
nema gde igla da padne	e ka në majë të gjuhës	SRB: samo što ne kažem nešto, znam to ali ne mogu da se setim u trenutku: Kako se zove hotel, znam na vrh jezika mi je. ALB: jam gati të them diçka, por s'e them dot, në këtë çast, e di mirë por s'më bie ndërmend a nuk më del nga goja: Si quhet hoteli, e di, e kam në majë të gjuhës.
vrzeti (smotati, okretati, motati) (nekoga) oko malog prsta	e sjell (e luan) në majë të gjishtit (gishtave)	SRB: imati vlas nad nekim, imati ogroman uticaj na nekoga, na nečije odluke, postupke, zaludeti nekoga: Ma nikoga ne sluša, ta devojka ga vrzi oko malog prsta. ALB: e sorllat, e tall si do vetë; ia hedh; ia punon: Nuk e dëgjon askënd, ajo vajzë e sjell në majë të gjishtit
vrh ledenog brega	maja e ajsbergut	SRB: samo mali vidljivi deo nečeg većeg, lošeg i opasnog: To što znaš je samo vrh ledenog brega, bolje da ti ne pričam dalje. ALB: pjesa e dukshme, më e vogël e diçkaje të keqe a të rrezikshme, pas së cilës fshihet gjithë e keqja: Ti e di vetëm majën e ajsbergut, më mirë të të mos tregoj tutje.

znati kao oče naš	në majë të gishtave	SRB: znati odlično, poznavati nešto, znati nešto napamet: Bio je stari morskı vuk, znao je plovidbu kao oče naš. ALB: shumë mirë, duke e njohur plotësisht; duke e ditur ujë; duke e ditur përmendësh: Ishte ujë i vjetër deti, e njihje lundrimin në majë të gishtave.
ne videti dalje od nosa	nuk sheh më larg se hunda e vet sheh gjet te maja e hundës	SRB: ne uočavati bitno; imati ograničena zapažanja i uske vidike: Naša je greška bola što u to vreme nismo videli dalje od našeg nosa, u suprotnom bismo puno napredovali. ALB: nuk i sheh gjërat e rëndësishme; i ka pikëpamjet e kufizuara: Gabimi ynë në atë kohë ishte se nuk shihnim me larg se hunda jonë, përndryshe kishim përparuar shumë.
puno je (nekome) srce poludeti od sreće biti pijan od sreće	më bëhet zemra mal (kala, bukë) m'u rrit zemra më gufoi zemra u bëra edhe (një herë) kaq (aq)	SRB: biti izuzetno srećan; vidljivo obuzet srećom; radostan, zadovoljan: Puno mi je srce kad čujem da su tvoja deca uspešna. ALB: gëzohem pa masë, u mbusha plot me gëzim: Më bëhet zemra mal kur dëgjoj që fëmijët e tu janë të suksesshëm.
tresla se gora, rodio se miš	u mbarrs mali e polli një mi shumë zhurmë për asgjë	SRB: diglo se mnogo buke ni oko čega; uveličavaju se stvari: U Skupštini se vodila žestoka rasprava, na kraju ništa nije bilo. Tresla se gora, rodio se miš. ALB: shumë u fol e shumë zhurmë u bë për diçka, por nuk doli ashtu; u fry shumë, por dha pak: Në Kuvend u zhvillua një diskutim i ashpër, por në fund nuk ndodhi asgjë. U mbraps mali e polli një mi.
pokriti se ušima	u bë mel	SRB: postideti se; povući se postideno: Kada je učiteljica ušla u učionicu, učenici se pokriše ušima i nisu se više čuli. ALB: u struk e s'u ndie më (nga frika, nga turpi): Kur mësuesja hyri në klasë, nxënësit u bënë mel e s'u ndien më.
nije mi vrana (svraka) popila mozak (pamet)	S'mi ka ngrënë (çokitur) sorra (pula) mendtë	SRB: nisam toliko glup da ne shvatim nešto: Nije mi vrana popila mozak pa da odem da mu ispričam. ALB: nuk jam aq i marrë e aq budalla që të mos marr vesh a të mos kuptoj diçka: Nuk m'i ka ngrënë sorra mendtë që të shkoj e t'i tregoj atij.
kao da je popio svu pamet sveta misli da je pojeo svu	shet mend u jep mend tjerëve i pëlqen mendja e vet	SRB: umišlja da je najpametniji i da sve najbolje zna: Ti što se ponašas kao da si popila svu pamet sveta, imaš li za sebe pameti? ALB: mbahet si më i mençuri a më i dituri dhe u jep këshilla të tjerëve: Ti që po shet mend, a ki mend për vete?
biti istog mišljenja (s nekim)	jam i një mendjeje	SRB: slagati se s nekim ili razmišljati na isti način: Po pitanju uslova rada, istog sam mišljenja kao i direktor. ALB: mendoj si dikush a pajtohem në mendim me të, nuk kam një mendim tjetër: Sa i përket çështjes së kushteve të punës, jam i një mendjeje me drejtorin.
biti istog mišljenja (s nekim)	ia mbush mendjen	SRB: ubediti; nametnuti svoje mišljenje, uverenja i sl.: Napunili su mu glavu drugovi da ide u vojsku. ALB: e bind më në fund për diçka, e bëj të mos jetë më i lëkundur a mëdyshas: Ia mbushën mendjen shokët të shkojë në ushtri
dozvati se pameti	i thirri mendjes (dikush)	SRB: postati razuman, bistar, priseban; opametiti se: Dozovi se pameti, sad si odrastao! ALB: u përpoq të përmbahet e të mendoj mirë për një veprim; nisi të arsyetojë si duhet e të kuptojë drejt: Thirri mendjes, tani je rritur.

razbijati (lupati) sebi glavu	vras mendjen rrah mendjen e vërtit nëpër mendje lodh mendjen vras kokën vras trutë	SRB: naporno misliti o nečem teškom i komplikovanom; mučiti sebe mislima: Sedim i razbijam sebi glavu šta ću, nemam drugog rešenja nego da uzmem kredit. ALB: mendohem shumë, përpiqem shumë për ta zgjedhur diçka; e arsyetoj dhe e rrah nga të gjitha anët diçka: Rri e vras mendjen si t'ia bëj, nuk kam zgjidhje tjetër pos të marr kredi.
zlatna sredina	e mesmja e artë	SRB: stanje ni tamo ni amo; postupak ili stav koji te ne dovodi u sukob sa sukobljenim stranama ili gde imaš koristi od obe strane; rešavanje nesporazuma gde su obe strane zadovoljno i koje ne dovodi do posledica: Ovo rešenje bilo je zlatna sredina za rešavanje nesporazuma i postizanje dogovora. ALB: gjendje as andej e as këtej; qëndrim ose veprim i cili nuk të çon në ndeshje me dy palët e kundërta dhe që lejon të kesh përfitime nga të dyja anët; zgjidhje e një kundërshtie pa asnjë pasojë; zgjidhe të mendohet se është më e mira: Kjo zgjidhje ishte e mesmja e artë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe arritjes së marrëveshjes.
ogrešiti se o nekoga ogrešiti dušu	hyj në gjynah bie në mëkat	SRB: učiniti neko zlo ili okriviti nekoga uzaludno; rečju ili delom dovesti nekoga u nezgodan položaj ili mu naneti štetu: Zaista, ogrešila sam se o čistačicu ali sam joj se izvinila. ALB: i bën keq ose e fajëson kot dike; ia punon padrejtësisht: Me të vërtetë hyra në gjynah me pastruesen, por i kërkova falje.
ostaviti (staviti) nešto po strani	lë (vë) mënjanë	SRB: sačuvati nešto za kasnije; uštedeti; zanemariti nekoga ili nešto, ne baviti se time, ne voditi računa o nekome ili nečemu; ne razmatrati: Ostavi taj sok po strani, da imamo kad dođu gosti. ALB: e vë diçka diku për ta ruajtur për më vonë a për ta kursyer; e vloy për më vonë; e kursej; heq dore prej dikujt a diçkaje; nuk merrem më me të, nuk kujdesem më për të, e lë në harresë, e braktis: Lë atë lëng mënjanë, ta kemi kur të vijmë mysafirët.
zubato sunce	Dielli me dhëmbë	SRB: sunce koje ne greje, obično zimi: Dobro se obuci, napolju je hladno. Ne daj da te prevari zubato sunce. ALB: dielli që nuk nxe, zakonisht në dimër: Vishu mirë se jashtë është ftohtë. Mos u mashtro nga dielli me dhëmbë.
stajati (držati se) po strani povući dušu u se držati barut na suvom	rrri mënjanë rrri në strofull (hije) është (rrri) jashtë valles	SRB: ne učestvovati u nečemu; ne mešati se u nešto: On je samo stajao po strani i slušao raspravu. ALB: nuk përzihet me të tjerët, nuk merr pjesë në një punë me ta; rri larg një ngjarjeje, një veprimtarie; është i tërhequr e indiferent: Ai vetëm rrinte mënjanë dhe e dëgjonte diskutimin.
očitati (održati) (nekome) lekciju (bukvicu)	i dha një mësim të mirë	SRB: izgrđiti, prekoriti nekoga; upozoravati na greške: Učiteljica mu je očitala lekciju zbog lošeg ponašanja. ALB: e qortoi si duhet a e ndëshkoi që të vërë mend: Mësuesja i dha një mësim të mirë për shkak të sjelljes së keqe.
živeti kao bubreg u loju živeti kao mali beg (bog, car)	si veshka në mes të dhjemit si veza në kulaç si pjergulla në fik si miu në miell ka rënë në mjaltë si pula në grurë (në thekër, në mulli) ka rënë në mjaltë	SRB: živeti u izobilju; izvrsno; uživati: Živi kao bubreg u loju, sa svim blagodetima. ALB: në kushte e rrethana shumë të mira, në mjedis të këndshëm a të rehatshëm; shumë mirë e s'ka më mirë: Jeton si veshka në mes të dhjemit, me gjitha të mirat.

belo roblje	mish i bardhë	SRB: žene i devojke koje se koriste za prostituciju: Trgovina belim robljem je prioritet koji moramo tretirati. ALB: gra dhe vajza që përdorën për prostitucion: Trafikimi me mish të bardhë është prioritet të cilin duhet ta trajtojmë.
nit' smrdi nit' miriše	as verë as uthull as mish as peshk	SRB: neodređeno je; nema individualnih osobina, ni jedno ni drugo, ni dobro ni loše: Ne znam šta da ti kažem za nju, nit' smrdi nit' miriše. ALB: i papërcaktuar mirë; pa tipare dalluese e pa një vlerë të qartë, as kështu e as ashtu: S'di ç'të them për të, as verë as uthull.
topovsko meso	mish për top	SRB: ljudi poslati u rat da ginu: U tim ratovima mladi nisu shvatali težinu dela, oni su bili samo topovsko meso. ALB: njerëz (ushtarë) që dërgohen në luftë me forcë, apo shkojnë verbërisht për t'u vrrarë për interesa të tjetërkujt: Në ato luftëra të rinjtë nuk e kuptonin barrën e veprave, ata ishin vetëm mish për top.
ići (leteti, kretati se, juriti, motati se) kao muva bez glave	si miza pa krye (kokë)	SRB: ići smeteno, smušeno, bezglavo, nasumice, nepromišljeno, bez plana, u velikoj žurbi: Gde si krenuo kao muva bez glave? ALB: pa një drejtim të caktuar; qorrazi, kuturu; që e bën diçka pa e ditur mirë, pa qenë i qartë e i sigurt: Ku je nisur ashtu si miza pa krye?
ići (lepiti se) kao pčela (pčele) na med	si mizat në mjaltë	SRB: ići, hrliti s oduševljenjem na nešto; grabiti se za nešto: Kad su ugledali svu tu hranu, odoše za sto kao pčele na med. ALB: të gjithë përnjëherësh e me kënaqësi për të përfituar nga diçka e mirë: Kur e panë të gjithë atë ushqim, shkuan si mizat në mjaltë.
biti (nešto) med i mleko	(është) mjaltë e qumësht (sheqer)	SRB: veoma dobar čovek; prijatan; slatkorečiv; slaže se sa svima: Svi su voleli baku jer je bila med i mleko. ALB: është shumë i mirë, i këndshëm, gojëmbël; shkon mirë me të gjithë: Të gjithë e donin gjyshen se ishte mjaltë e qumësht.
osedeti (neko) iskriviti vrat	më doli mjekra më dolën thinjat m'u zgjaten veshët	SRB: predugo čekati nekoga ili nešto: Osedeo sam čekajući da se ona spremi. ALB: një kohë të gjatë jam duke e pritur dikë a diçka; u mërzita duke shpresuar për diçka: Me doli mjekra duke pritur që ajo të bëhet gati.
trljati dlanove (šake, ruke)	fërkon mjekrën fërkon duart	SRB: biti zadovoljan nekim ili nečim: Zadovoljno je gledao radnike na polju i trljao dlanove. ALB: është i kënaqur me diçka që ka ndodhur, gëzohet: Me kënaqësi i shikonte punëtorët në fushë dhe e fërkonte mjekrën.
Zabranjeno voće	fruta të ndaluara	SRB: stvar koja se ne sme dirati ili o kojoj ne treba govoriti; tabu: Bacio je oko na devojku koja je za njega bila zabranjena jabuka. ALB: diçka që nuk lejohet të përdoret a të shfrytëzohet; diçka që nuk lejohet të bëhet; diçka e dëshiruar por e paarritshme a e ndaluar për të gjithë: Ia ka hedhur syrin asaj vajze, por ajo për të ishte frutë e ndaluar

okretati se (ići, povijati se) kako vetar duva	e kthen shpinën (gunën, kurrizin, krahët) nga të fryjë era si të jetë moti e kthen gëzofin	SRB: postupati, upravljati se, menjati svoje stavove prema okolnostima, prilikama, biti prevrtljiv, gledati svoj interes: Diplomata ti je ona, okreće se kako vetar duva. ALB: ndërron shpejt bindjet sipas rrethanave e sipas interesit vetjak: Diplomate është ajo, e kthen shpinën nga të fryjë era.
rekla-kazala	muhabete pazari	SRB: nepouzdana priče; tračevi; naklapanje, izmišljotine: Pusti te priče rekla-kazala, otkud znaš da je to tačno. ALB: diçka për të cilën flitet poshtë e përpjetë, por nuk është e sigurt; thashetheme: Lëri ato muhabete pazari, nga e di ti që ajo gjë është e saktë.
borba a vetrenjaçama	lufton me mullinjtë e erës	SRB: uzaludna, besmislena, bezizgledna borba: Boriš se s vetrenjaçama, nećeš postići svoj cilj. ALB: i turren diçkaje të kotë a të hamendësuar; hidhet kundër diçkaje që e mendon si të rrezikshme dhe harxhon kot forcat e mundin: Po lufton me mullinjtë e erës, nuk do ta arrish qëllimin tënd.
razlikovati se kao nebo i zemlja (dan i noć)	si nata me ditën	SRB: biti sasvim različit; puno se razlikovati: Ne možeš uporediti njih dve, iako su sestre razlikuju se kao nebo i zemlja. ALB: ne shumë dallime njëri nga tjetri; e kundërta e njëri-tjetrit, as që mund të krahasohen: Nuk mund t'i krahasosh ato dy, edhe pse janë motra janë si nata me ditën.
šta seješ to i žanješ	çfarë mbjell (edhe korr) çfarë ndjell (edhe) mbështjellë	SRB: što činiš, tako ti se vraća: Pazi šta radiš, kako seješ, tako ćeš žnjeti. ALB: çfarë bën atë gjen; sipas punës e merr shpërblimin: Ki kujdes çka po bën, çfarë mbjell do të korrësh.
iskidati (pokidati, iseći) (nekome) nerve (živce)	ia ngriti (acaroi) nervat (dikujt)	SRB: nervirati; razdraživati nekoga: Razgovor sa njim mi je iskidao živce jer priča gluposti. ALB: e nevrikos, e inatos, e zëmëroi dike; nuk duron dot më, shqetësohet e mërzhitet shumë dikush: Biseda me të më ngriti nervat sepse fliste marrëzi.
iskidati (pokidati, iseći) (nekome) nerve (živce)	e zë në gojë	SRB: govoriti o nekome, nečemu; spominjati nekoga ili nešto: Govoreći o običajima, uzela je u usta i svoju snaju. ALB: flas për dikë a diçka; e përmend: Duke folur për zakone e zuri në gojë edhe të renë e saj.
imati dubok džep biti dubokog džepa	e ka xhepin (kuletën, qesen) e ngrohtë	SRB: pun para; bogat; imućan: U to vreme trgovci su imali duboke džepove. ALB: ka shumë para; është në gjendje të mirë ekonomike: Në atë kohë tregtarët e kishin xhepin më të ngrohtë.
iznositi (nečiji) prljav veš	ia nxori të palarat (në sheh) (dikujt)	SRB: govoriti o nekome ružne stvari: Nije lepo da sad iznosiš o njoj prljav veš, bile ste najbolje drugarice. ALB: ia nxori në sheh dallaveret që ka bërë; ia zbuloi të gjitha veset, të këqijat a veprimet e ulëta; e demaskoi: Nuk është mirë që tani t'ia nxjerrësh të palarat, ishit shoqe më të ngushta.
na prvi pogled	në pamje të parë	SRB: odmah, smesta, čim se ugleda, nakon površnog posmatranja, bez udubljanja u nešto: Na prvi pogled izgledao je da je pravedan, ali se kasnije pokazalo da ga samo novac interesuje. ALB: sipas përshtypjes që kemi nga ana e jashtme, pa i hyrë në brendësi a në thelb, në dukje: Në pamje të parë dukej si njeri i drejtë, por më vonë u tregua se atë vetëm lekët e interesojnë.

biti kvit (s nekim)	jemi paq	SRB: biti jednak, isti, izjednačen s nekim; biti načisto s nekim: Platiao sam ti dug koji si mi pozajmio i sad smo kvit. ALB: nuk kemi më llogari për të larë me njëri-tjetrin, jemi të larë, as më ka as i kam: Ta pagova borxhin që ma dhe hua, tani jemi paq.
pucati od besa	më vjen të pëlças	SRB: prekomerno se ljutiti: Dođe mi da puknem od besa kad se setim koliko sam skupo platiao košulju. ALB: shumë inat, nuk e përmbaj dot vetën; më ka zemëruar shumë dikush a diçka: Më vjen të pëlças kur më kujtohet sa shtrenjtë e pagova këmishën.
liçiti (sliçiti, nalikovati) kao jaje jajetu (kao dve kapi	janë (o=përngjajnë) si dy pika uji	SRB: biti veoma sličan nekome, nečemu, biti skoro identičan s nekim, s nečim: Nisu blizanci, ali liče kao jaje jajetu. ALB: ngjajnë shumë me njëri-tjetrin, janë pothuajse të njëjlojtë: Nuk janë binjakë, por janë si dy pika uji.
slaba tačka bolna tačka	pikë e dobët	SRB: slabost, nedostatak, nezgodna ili neprijatna strana nekoga ili nečega; negativna osobina, nedostatak u nečemu; ono u čemu je neko osetljiv: Matematika mi je uvek bila slaba tačka. ALB: diçka shumë e dobët, që thyhet a prishet lehtë; njeriu që më bën të vuaj; dikush që e dua shumë e për të cilin kam më shumë dobësi se sa për të tjerët; anë e karakterit a pjesë e veprimtarisë së dikujt që mund të shfrytëzohet nga të tjerët për ta goditur; ana e dobët; gjëja në të cilin dikush ndjehet i pafuqishëm të veprojnë: Matematikën gjithmonë e kam pasur pikë të dobët.
do poslednje kapi krvi	deri në pikën e fundit të gjakut	SRB: do smrti; dok dišem: Borila se za svoje dete do poslednje kapi krvi. ALB: deri në vdekje; sa jam ende gjallë: Luftoi deri në pikën e fundit të gjakut për fëmijën e saj.
kap (vode) u moru	një pikë ujë në oqean	SRB: neznatna, ništavna količina (u odnosu na potrebe); nešto što ne može imati nikakvog uticaja: To što mu sestra pomaže je samo kap u moru. ALB: diçka shumë e vogël, sasi e pallogaritshme, gjë që s'duket fare: Kjo që i ndihmon motra është vetëm një pikë ujë në oqean.
doći do mrtve tačke	pika e vdekur	SRB: naći se u situaciji, problemu koji nije moguće razrešiti: Čini se da čekaju znak da pokrenu razgovore s mrtve tačke. ALB: gjendje amullie; pa rrugëdalje e pa zhvillim të mëtejshëm; ngecje në vend: Duket se po e presin një shenjë për t'i lëvizur bisedimet nga pika e vdekur.
Biti (naći se) u škripcu	jam pisk (ngushtë)	SRB: biti, naći se u teškoj, bezizlaznoj situaciji; biti u ozbiljnim problemima i teškoćama: Trenutno sam u škripcu s novcem, ako možeš da mi pozajmiš do početka meseca. ALB: jam në gjendje shumë të vështirë, të rëndë a të rrezikshme; nuk di çka të bëj a nga t'ia mbaj; nuk kam rrugëdalje: Në këtë moment jam pisk me para e nëse mund t'më japësh ca hua deri në fillim të muajt.
dobiti (nešto) na tanjiru (tacni)	ia dha në pjatë	SRB: dobiti nešto bez truda, na gotovo: Otac mu je sve ostavio na tacni, a on to nije umeo da sačuva. ALB: ia mbaroi një punë gjithë vetë e nuk e la të lodhet ose të mundohet; ia bëri diçka krejt gati; ka marrë diçka pa e bërë asnjë përpjekje: Babai ia dha të gjitha në pjatë, e ai nuk diti t'i ruajë.

lavovski deo	pjesa e luanit	SRB: nesrazmerno veliki deo, osetno najveći i najbolji deo: Agencije za prodaju stanova svakako uzmu lavovski deo od prodaje. ALB: pjesa më e madhe a më e mirë e diçkaje: Agjencitë për shitje të banesave gjithsesi e marrin pjesën e luanit nga shitjet.
pokupiti prnje	mbledh plaçkat	SRB: biti proteran sa jednog mesta ili pobeći sa jednog mesta na drugo: Od srama, pokupio je svoje prnje e nije se više vraćao u kancelariju. ALB: u shpërngul dhe shkoi në një vend tjetër; u largua me turp a i përzënë nga dikush: Nga turpi i mblodhi plaçkat e veta dhe nuk u kthye më në zyre.
živa (otvorena) rana	plagë e hapur	SRB: bolna, mučna uspomena, tuga koja ne prolazi: Iako je prošlo puno godina, smrt sina joj je i dalje bila živa rana. ALB: dhembje shpirtërore a fatkeqësi që ka kaluar e nuk është mbyllur, vuajtje e thellë a brengë që nuk është fashitur: Edhe pse kishin kaluar shumë vite, vdekja e djalit kishte mbetur plagë e hapur për të.
pasti s nogu	jam bërë pleh	SRB: jako se umoriti, premoriti, malaksati od mnogo posla: Momci su pali s nogu od radova u polju. ALB: jam lodhur shumë, u këputa nga punët, jam rrraskapitur: Djemtë janë bërë pleh nga punët në fushë.
puno je srce (nekome)	e kam zemrën plot	SRB: biti zadovoljan, srećan: Puno mi je srce kad vidim unuke. ALB: jam shumë i kënaqur, i lumtur, i gëzuar se kam gjithçka, kam gjithë ata që i dua e ashtu si i dua: E kam zemrën plot kur i shoh nipërit.
pasti u prašinu prekriti se prašinom (zaborava) prašina pada na nešto	pasti u prašinu prekriti se prašinom (zaborava) prašina pada na nešto	SRB: pasti u zaborav, biti zaboravljen: Odavno je pala prašina na tu priču, niko je se više i ne seća tačno. ALB: është harruar fare, nuk e kujton më njëri; ka një kohë të gjatë që nuk përdoret: Moti e ka mbuluar pluhuri atë tregim, askush nuk e mban mend më saktë.
brz kao zec brz kao munja	plumb pushke	SRB: izuzetno brz, munjevit, hitar: Neka ovo pismo odnese neko ko je brz kao munja, hitno je! ALB: shumë i shpejtë; me shpejtësi të madhe, rrufe, vetëtimë, sa nuk dihet kur ikën: le ta dërgojë këtë letër dikush që është plumb pushke, është urgjente!
naći se (biti) nekome pri ruci	i rri (qëndroj) pranë (dikujt a diçkaje)	SRB: biti nekome od pomoći, od koristi; biti u nečijoj blizini kako bi pomogao kada zatreba; pružiti pomoć: Komšinica mi se u starosti našla pri ruci, svakoga dana mi donese hleba i zajedno pijemo kafu. ALB: kujdesem shumë për dikë a diçka; vazhdimisht e në mënyrë të veçantë; e ndihmoj a e mbroj në çdo rast dikë: Fqinja më rri pranë në pleqëri, çdo ditë më sjellë bukë dhe e pimë kafenë së bashku.
slomiti (polomiti, pokidati) lance	këput zinxhirët (zinxhirin, hallkën) they (këput) prangat	SRB: osloboditi se ropstva, stega, kontrole: Na kraju su uspjeli da pokidaju lance i oslobode se jednom zauvek. ALB: çlirohëm, fitoj lirinë, shpëtoj me forcë nga një sundim a nga një shtypje: Në fund arritën t'i këputin zinxhirët njëherë e përgjithmonë.
ići s kokoškama u krevet spavati s kokoškama	bie me pulat	SRB: spavati već sa prvim mrakom; veoma rano legati: Svakoga dana ustaje u 5, ali zato spava s kokoškama. ALB: fle shumë herët, nuk duron të rrijë vonë: Çdo ditë zgjohet në orën 5, por bie me pulat.

princ iz bajke princ na belom konju	princi i kaltër	SRB: muškarac iz devojčkih maštanja, snova, idealizovani muškarac kakvog devojke priželjkiju za svog budućeg: Nije se još udala, ne znam šta čeka princa na belom konju. ALB: djalošh i ëndërruar nga një vajzë në moshë martese, shumë i bukur e shumë i mirë, si i rënë nga qielli, vjen për ta marrë e për t'u martuar me të: i dashuri i ëndërruar: Ende nuk është martuar, s'di çka po pret, princin e kaltër.
princ iz bajke princ na bnema za šta pas da ga/je ujedeelom konju	nema za šta pas da ga/je ujede s'ka ku ta kapë (ta zërë) qeni	SRB: veoma siromašan čovek: Prosjak je to, nema pas za šta da ga ujede. ALB: zhele-zhele, i zhveshur e i zbathur; shumë i varfër e i këputur: Lypës është, s'ka ku ta kapë qeni.
kao pušten s lanca (neko)	qen i lëshuar nga zinxhiri	SRB: onaj koji ne može da se uzdrži; gladan i žedan nečeg: Vojnici su, kao pušteni s lanca, pojurili u kafane da odmore od svakodnevnih vežbi. ALB: njeri i papërmbajtur; ai që sillet si i tërbuar; njeri i uritur për diçka: Ushtarët, si qen të lëshuar nga zinxhiri, ia mbathen kafeneve për të pushuar nga ushtrimet e përditshme.
pa makar i sekire padale s neba	(sikur) qeni qepën ta hajë!	SRB: bezuslovno, u svakom slučaju, bez obzira na prilike, po svaku cenu: Pa makar i sekire padale s neba, ima da ideš sutra u školu! ALB: medoemos, me çdo kusht, patjetër; sido që të bëhet: Sikur qeni qepën ta haje nesër do të shkosh në shkollë!
spavati mirnim snom spavati snom pravednika	e bëj gjumin e qetë	SRB: spavati bezbrižno; bez griže savesti: Ako živiš od svog rada, spavačesh mirnim snom. ALB: nuk e ndej vetën fajtor për asgjë dhe nuk i detyrohem askujt; jam i qetë, nuk ka arsye të më vrasë ndërgjegjja: Po jetove nga djersa jote do ta bësh gjumin e qetë.
pasti s neba	ra nga qielli	SRB: dobiti nešto neočekivano i bez truda: Svo bogatstvo je stekao radom, nije mu palo s neba. ALB: u bë ose erdhi vetvetiu diçka, papritur e pa mundim: Të gjithë pasurinë e fitoi me punë, nuk i ra nga qielli.
tražiti đavola sa svećom	e kërkon sherrin me qiri	SRB: bespotrebno se izlagati opasnosti, srljati: Gde je tuča, tu je on, traži đavola sa svećom. ALB: është grindavec, kërkon në çdo mënyrë shkak për t'u grindur; është i gatshëm për të bërë sherr: Ku ka kacafytje, atje është edhe ai, e kërkon sherrin me qiri.
zažmuriti na jedno oko	e bën një sy qorr (të verbër) mbyll një sy mbyll një sy e një	SRB: namerno ne uočiti; ne želeti videti nešto; praviti se nevešt; ne želeti se suočiti sa činjenicama: Svako jutro je kasnila na posao, ali direktor je uvek žmurio na jedno oko. ALB: bën sikur nuk sheh ose nuk i intereson për dikë a për diçka; bën lëshime: Çdo mëngjes vonohej në punë, por drejtori gjithnjë e bënte një sy qorr.
biti gola voda	u bë qull (ujë, pellg, dordolec, xurxull) u bë si gjuha në gojë	SRB: biti veoma oznojen, potpuno mokar: Od napornog vežbanja na treninzima, kući se vraćao gola voda. ALB: i lagur shumë, i tëri u lag: Nga ushtrimet e vështira në stërvitje kthehej në shtëpi i bërë qull.
upasti (nekome) kašika (sekira) u med	i ra luga në qumësht	SRB: doći do velike dobiti i živeti bez poteškoća, u izobilju: Mučio se u mladosti, sad mu je upala kašika u med, uživa. ALB: i shkojnë punët mbarë, jeton mirë e pa vështirësi; nuk vuan: Është munduar në rini, tani i ka rënë luga në qumësht, po kënaqet.

mirisati (još) na majčino mleko biti u pelenama	s'i kanë dalë ende dhëmbët i ka buzët me qumësht	SRB: biti premlad; neiskusar; nezreo: Miriše još na majčino mleko, a misli da je najpametniji. ALB: është ende i parritur; i papjekur; nuk e ka rrahur ende jeta; nuk ka përvojë: S'i kanë dalë ende dhëmbët, e mendon që është më i mençuri.
Kako (kao) što je red i običaj	si e do radha	SRB: kako, kao što je uobičajeno, kako svi rade, kako se pristoji: Kao što je red i običaj, ustala je i ustupila mesto baki u autobusu. ALB: ashtu si duhet, si kërkohet dhe si është më mirë, sipas rregullit: Si e do radha, u çua dhe ia lëshoi vendin gjyshe në autobus.
čitati između redova	lexoj midis rreshtave (rradhëve)	SRB: naslutiti i ono što nije direktno izrečeno, razumeti prikriveni smisao: Mnogo toga na sastanku nije direktno rečeno, pa smo morali da čitamo između redova. ALB: gjej kuptimin e brendshëm të diçkaje që është shkruar; kuptoj mendimet e fshehta që përmban diçka e shkruar apo e thënë: Shumë çka nuk u tha drejtpërdrejtë në takim, andaj duhej të lexonim midis rreshtave.
zbiti redove	shtrëngoj (ngjesh) radhët	SRB: pribiti se jedan uz drugoga; postati složan ili još složeniji, solidarisati se jedan s drugim radi ostvarenja nekog cilja, neke ideje: Zbijte redove, ujedinite se protiv ovog zla! ALB: bashkohem e lidhem fort me të tjerë për t'u mbrojtur ose për të përballur diçka: Shtrëngoni radhët, bashkohuni kundër kësaj të keqe!
pustiti mozak na ispašu lutaju misli (nekome) biti odsutan duhom	i kullot retë i bredhin mendja i kullot mendja iu arratis mendja i fluturon (i ikën) mendja i livadhis mendja	SRB: ne misliti o onom što se trenutno govori ili dešava; biti rasejan ili dekoncentrisan; isključiti mozak: Pustio je mozak na ispašu, nije čuo ništa tokom časa. ALB: është i shpërqendruar; i shpërndarë dhe i hutuar; mendon për gjëra të ndryshme; nuk përqendrohet dot në një gjë; nuk e ka mendjen aty: I kullotë retë, nuk dëgjoji asgjë gjatë mësimit.
sisati dve majke	me njërën dorë në revani e tjetrën në bakllava ha me dy lugë	SRB: crpiti korist s dve strane (s više strana): Dugo je sisao dve majke, tome je došao kraj. ALB: duke përfiturar nga të dyja anët; me të gjitha të mirat: Gjatë qëndroi me njërën dorë në revani e tjetrën në bakllava.
biti tvrd na ušima	është i rëndë nga veshët i ka veshët e rëndë	SRB: biti nagluv; slabo čuti: Moraš glasnije da mu kažeš, tvrd je na ušima. ALB: nuk dëgjon mirë; mezi dëgjon: Duhet t'i thuash më zë më të lartë, është i rëndë nga veshët.
sravniti sa zemljom	u bë rrafsh me tokën	SRB: potpuno uništiti; razoriti do temelja: Zemljotres je bio veoma jak i mnoge kuće su se sraunile sa zemljom. ALB: u prish që nga themelet; u rrafshua; u shkatërrua krejt: Tërmeti ishte shumë i fortë dhe shumë shtëpi u bënë rrafsh me tokën.
sravniti sa zemljom	rrallë e tek	SRB: ponegde; ovde-onde; katkad; ponekad: 60-ih godina nije bilo puno automobila, tu i tamo bi neki prošao ulicom. ALB: nganjëherë e me ndërprerje të gjata, vetëm ndonjëherë: Gjatë viteve të gjashtëdhjeta nuk kishte shumë makina, rrallë e tek kalonte ndonjë nëpër rrugë.

traçak nade	një fije shpresë rreze drite	SRB: poslednja nada; malo nade u nešto: Još uvek je postojao traçak nade za nju, iako je pala na svim ispitima. ALB: pak shpresë që lind për diçka: Akoma kishte një fije shpresë për të, edhe pse ra në të gjitha provimet.
saseçi (preseçi, uništiti, zatrti) u korenu	shkul nga rrënjët	SRB: uništiti potpuno, do kraja, sasvim; onemogućiti nešto već na samom početku; ne dozvoliti nečemu da se razvije: Korupciju treba saseçi u korenu. ALB: heq çdo mundësi për të jetuar; shfaros, zhduk, zhbij dikë a diçka; e shkatërroj nga themelet ose që nga fillimi e pamundësoi të zhvillohet: Korrupsioni duhet të shkulët nga rrënjët.
nisam našao (nekoga ili nešto) na ulici	nuk e kam gjetur në rrugë	SRB: steći nešto sopstvenim radom; odgajati nekoga ko je tvoj: Radim marljivo da mi ne propadne firma jer je nisam našao na ulici. ALB: kam arritur me përpjekje, me djersë e mundime diçka; e kam rritur me mundime sepse është e imja: Punoj me zell për të mos më shkuar poshtë biznesi sepse nuk e kam gjetur në rrugë.
çiniti (raditi) nešto reda radi kao mačka repom	sa për sy e faqe sa për sytë e botës sa për "shihni botë!"	SRB: samo kako bi drugi videli ili znali da je nešto učinjeno; ne činiti nešto od srca: Nije mu se išlo na svadbu ali je otišao reda radi. ALB: sa për t'u dukur përpara të tjerëve, për ta parë a për ta ditur të tjerët; sa për t'u quajtur se u bë diçka ose se është në rregull; jo me çiltërsi e më gjithë zemër: Nuk dëshironte të shkonte në dasmë por shkoi sa për sy e faqe.
na brzu ruku pet na devet	shkel e shko rrush e prush shpejt e shpejt	SRB: na brzinu, površno; letimično: Majstori su nam izgradili kuću na brzu ruku. ALB: me nxitim e pa kujdes, dosido; keq: Mjeshtrit na e ndërtoan shtëpinë shkel e shko.
kucnuo je čas	ra sahati (ora)	SRB: došlo je vreme, pravo je vreme; odgovarajući je trenutak: Kucnuo je čas da konačno kažem šta imam. ALB: erdhi koha; është koha e duhur: Ra ora më në fund të them çfarë kam.
krenuti nizbrdo	mori teposhtën (tatëpjetën, rrokullimën) e mori vala mori të zezën	SRB: pogoršavati se; nazadovati; propadati: Umesto da napreduje nakon toliko godina rada, ona je pošla nizbrdo. ALB: bëhet gjithnjë e më keq; shkon drejt një gjendjeje gjithnjë më të keqe: Në vend të përparojë pas aq shumë vitesh punë, ajo e mori teposhtën.
ne veruje svojim očima	nuk u beson syve të vet	SRB: ne veruje ničemu i nikome; veoma je pažljiv; nepoverljiv je: Taj čovek ne veruje ni svojim očima, a kamoli nama. ALB: kërkon t'i vërtetojë e t'i saktësojë mirë gjërat; është mosbesues e shumë i kujdesshëm: Ai njëri nuk u beson as syve të vet, e jo të na besojë neve.
ne videti prst pred okom	t'i futësh gishtat në sy	SRB: veoma je mračno, potpuna tama; toliko je mračno da se ništa ne vidi: kada sam bio mali nisam smeo da odlazim u podrum kuće jer je tamo bilo toliko mračno da nisi video prst pred okom. ALB: është errësirë e madhe, sa nuk mund të shohësh as dy hapa larg: Kur isha u vogël nuk guxoja të shkoja në bodrum të shtëpisë sepse atje ishte aq errët sa t'i futësh gishtat në sy.
beži mi s očiju ne izlazi mi na oči beži da te moje oči ne	hiqmu (sporrnu) nga sytë!	SRB: ne želim da te vidim; nestani: Beži mi s očiju lopove! ALB: largohu nga unë e mos me dil përpara; zhduku!; nuk dua të të shosh!: Hiqmu nga sytë, haj!

ne ispuštati iz vida	nuk ia ndaj sytë nuk e lëshoj nga sytë	SRB: konstantno i neprekдино posmatrati ili gledati u nešto ili nekoga: Majka nije ispuštala dete iz vida, ali u sekundi ono je palo dok se igralo. ALB: nuk i shkëput vështrimin; e shoh pandërprerë: Nëna nuk ia ndatë sytë fëmiut, por për në sekondë u rrezua deri sa ishte duke luajtur.
zbog lepih oçiju na lepe oçi	për sytë e bukur	SRB: bez razloga, bez truda; nezasluženno: Ne možeš dobiti dobru ocenu na lepe oçi, sedi i uçi! ALB: jo sepse e meriton; për hatër të dikujt: Nuk mund ta marrësh notën e mirë për sytë e bukur, ulu e mëso!
zavijati u foliju	lyej me sheqer	SRB: ulepšavati ili ublažavati nešto što je loše: Prestani da zavijaš u foliju i nazovi stvari pravim imenom. ALB: përpiqet ta zbukurojë e ta fshehtë thelbin e keq e diçkaje duke përdorur fjalë më të ëmbla e më të buta: Ndalo të lyesh me sheqer dhe quaj gjërat me emër të vërtetë!
jasno kao dan jasno kao sunce	dukej sheshit	SRB: potpuno jasno, očigledno; nesumnjivo: Bilo je jasno kao dan da nije volela Nikolu. ALB: është fare e qartë; nuk ka nevojë të dëshmohet apo të shpjegohet; e shohin të gjithë se ashtu është: Dukej sheshit që nuk e donte Nikollën.
na prvi pogled	në shikim (në vështrim) të parë	SRB: odmah, s mesta; čim se ugleda, nakon površnog posmatranja; bez udublivanja u nešto: Na prvi pogled delovao je kao dobar momak. ALB: në dukje, pa hyrë në thelb e në hollësira, sipërfaqësisht: Në shikim të parë dukej si djalë i mirë.
bračni drug/ drugarica životni saputnik/ saputnica	shoku (shoqja) e jetës	SRB: supružnik: Bez očekivanja, našao je svoju životnu saputnicu. ALB: bashkëshorti: Pa pritur e gjeti shoqen e jetës.
dići glavu (čelo)	e drejtoj shpinën	SRB: biti ponosan: Digao je glavu samo zahvaljujući svom radu. ALB: u bë krenar: E drejtoj shpinën vetëm falë punës së vet.
zabosti nož u leđa	të ha pas shpine	SRB: izdati nekoga podmuklo: Mislio sam da mi je prijatelj, a on mi je zaboo nož u leđa. ALB: të tradhton a ta bën të keqën fshehurazi; nuk është i
položiti račun	kërkoj llogari	SRB: pozivati nekoga na odgovornost; tražiti od nekoga da se objasni i opravda: Radnici su tražili da položi račune od direktora, pre nego što ode iz kompanije. ALB: kërkoj nga dikush të mbajë përgjegjësi; kërkoj nga dikush të shpjegojë ose të arsyetojë ndonjë veprim: Punëtorët kërkuan llogari nga drejtori para se të shkonte nga kompania.
duša me boli za nekoga ili nešto duša me boli zbog nekoga ili nečega	më dhëmb shpirti (për dikë a diçka)	SRB: osećati veliku tugu i žal zbog nekoga ili nečega: Duša me boli za tu siromašnu porodicu, ni za hleba nemaju. ALB: më dhimbset dikush a diçka: Më dhëmb shpirti për atë familje të varfër, s'kanë as për bukë.
nemati duše	Nuk ka shpirt	SRB: biti nemilosrdan; bezosećajan; nesposoban za razumevanje tuđih nevolja i muka: Sudija nije imao duše, ali je sudio pravično. ALB: i pa mëshirshëm; zemërgurë: Gjykatësi nuk kishte shpirt, por gjykonte drejtë.

<p>pao je kamen (nekome) sa srca</p>	<p>M'u lehtësua shpirti</p>	<p>SRB: neko je osetio veliko olakšanje, odahnuo je; oslobodio se strepnje: Kada je oženila najmlađeg sina pao joj je kamen sa srca. ALB: u çlirova nga një ankth a nga një brengë; u qetësova shpirtërisht: Kur e martoi djalin e vogël iu lehtësua shpirti.</p>
<p>ne šišati nekoga</p>	<p>nuk ia var torbën (trastën, këmborën) (dikujt)</p>	<p>SRB: ne obraćati pažnju na nekoga; ne uzimati nekoga ili nešto u obzir; ne mariti za nekoga: Ma ko ga šiša, uvek kasni, neću ga čekati više ni minut. ALB: nuk e përfill aspak, nuk e pyet për asgjë dhe nuk i bindet; nuk e vlerëson fare, nuk i jep fare rëndësi: Nuk ia var torbën, gjithmonë vonohet, nuk do ta presë më asnjë minutë.</p>
<p>biti na raskrsnici (raskršću)</p>	<p>jam (gjendem) në udhëkryq</p>	<p>SRB: imati više opcija za birati, ne znati koju odabрати ili kojim putem ići; ne moći se odlučiti za nešto, nekoga: Na životnoj sam raskrsnici, otići odavde ili ostati. ALB: nuk e di se ç'rruge të zgjedh për të bërë diçka, nuk di nga t'ia mbaj; nuk mund të vendosi për diçka: Jam në udhëkryq të jetës, të shkoj nga ky vend apo të rri.</p>